



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT**

Nr.12/212 Prot

Tiranë, më 04.03.2020

V E N D I M

Nr. 13, datë 21.02.2020

Trupa e Vlerësimit e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, e përbërë nga:

Elvira Daberdaku	Kryesues
Elida Liko	Relator
Ana Kapaj	Anëtar

asistuar nga anëtarët e sekretariatit teknik, Eralda Bajollari dhe Laert Elmazaj, me datë 21.02.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (Ish Pallati i Kongreseve), Salla B, Kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Znj. Aida Veizaj**, me funksion Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, e pranishme në seancë dëgjimore.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit**

BAZA LIGJORE: **Ligji Nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar,

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

Ligjin nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA VLERËSUESE E KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, Elida Liko, dëgjoji shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANA TË ÇËSHTJES

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit është organi që bën vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në pikën 1 të nenit 5, dhe në pikat 1 dhe 5, të nenit 6, të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.
2. Znj. Aida Veizaj, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka ushtruar detyrën e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si rrjedhojë bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, i është nënshtuar procesit të vlerësimit, duke u shortuar me datë 03.06.2019, në përputhje me “Rregulloren për Proceduat e Zhvillimit të Shortit në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit”.
3. Në hedhjen e shortit të datës 03.06.2019, u përzgjedh trupa e vlerësimit nr. 1, ku në shortin e hedhur për znj. Aida Veizaj, kryesuese e trupës u zgjedh Elvira Daberdaku, relatores Elida Liko dhe anëtare Ana Kapaj. Në respektim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të vlerësimit për subjektin e vlerësimit. Në datë 19.06.2019 është njoftuar subjekti i vlerësimit për hapjen e hetimit ndaj tij.
4. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin për kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
5. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun IV, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 35 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të vlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimin e atyre që janë të përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.

6. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 43 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e nivelit të arsimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga punonjësit.
7. Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit janë administruar dokumentat shkresore të ardhura nga të gjithë institucionet apo personat juridikë, publikë apo private, të cilët sipas këtij ligji mbartin detyrimin të japin të dhëna për subjektet e vlerësimit.
8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, duke kryer një hetim të thelluar administrativ mbi të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
9. Trupa e vlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, dhe pasi konstatoi se janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit në datë 17.02.2020 vendosi mbylljen e hetimit për znj. Aida Veizaj. Mbështetur në nenet 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative dosja i është vënë në dispozicion subjektit të vlerësimit, duke i kaluar barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
10. Trupa e vlerësimit pasi u njoh me shpjegimet e subjektit të vlerësimit për relacionin paraprak, në datën 18.02.2020, nëpërmjet kryesuesit të seancës njoftoi me email subjektin e vlerësimit për mbajtjen e seancës dëgjimore, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit znj. Aida Veizaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, në datën 21.02.2020, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (Ish –Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0.
12. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i vlerësimit iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupës së vlerësimit, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit paraprak, si dhe procesin e vlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Subjekti i vlerësimi znj. Aida Veizaj ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur; ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjithë fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT

Procesi i vlerësimit i kryer nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, është bazuar në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar. Ky proces kryet me qëllim për të siguruar institucione të forta e të besueshme, me profesionistë me integritet.

Bazuar në nenet 48, 51 dhe 52 dhe pikën 1 të nenit 54 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, Trupa e Vlerësimit kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) deklaratën “Vetting” dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës të dorëzuar nga vetë subjekti i vlerësimit; (b) deklaratat e pasurisë të dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit pranë ILDKPKI –së në periudhat që ka qenë subjekt i deklarimit pranë këtij institucioni; (c) provat shkresore/dokumentat e administruara nga organet publike dhe private; (ç) deklaramet dhe përgjigjet e subjektit të vlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i vlerësimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Trupa e vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësën dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

Në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në datë 03.05.2018, subjekti i vlerësimit znj. Aida Veizaj, deklaroi këto pasuri të paluajtshme dhe likuiditete:

- 1. Apartament¹ me sipërfaqe 58.6 m² me adresë: Rruga “****”, Pll. ***, Ap.***, Tiranë në emër të babait z. Sh. H i cili nuk jeton më. Ky apartament nuk është i rivlerësuar. Subjekti i vlerësimit banon në këtë apartament.**

¹ Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar dokumentacion justifikues:

- Kontratë blerje të apartamentit nga babai z. Sh. H., me nr. *** Rep, nr. *** Kol. Data 17.06.1999, noter B. S., me çmim 1,700,000 lekë. Shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitjeje nga babai z. Sh. H., me nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 14.06.1999, të apartamentit në Rr. ***, Tiranë, me çmim 1,900, 000 lekë. Shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë blerjeje apartamenti, nga babai z. Sh. H., me nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 14.01.1997, Rr. ***, Tiranë, me çmim 1,500,000 lekë. Shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje të apartamentit, datë 31.12.1996, nga notere znj. A. P., me shitës Sh. H., H. H., L. H., A. H., me çmim 1,400,000 lekë. Shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Pjesa takuese: 0%
Vlera e deklaruar: 1,700,000 lekë

Fakte që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

- 1.1. Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug², konfirmon pronësinë e apartamentit me sipërfaqe 58.6m², në zk. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, në emër të babait të subjektit të vlerësimit z. Sh. H. Në dokumentacionin e dërguar nga ky institucion është bashkëlidhur Kontrata e Shitblerjes së apartamentit, në datë 17.06.1999 me nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol. Çmimi i blerjes është në vlerën 1,700,000 lekë.
- 1.2. Dhoma Kombëtare e Noterisë³, noter z. R. D ka vënë në dispozicion Kontratën e Shitblerjes me nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol, datë 14.06.1999 të apartamentit 1+1, në Rr. *** në Tiranë me shitës z. Sh. H. Çmimi i shitjes është 1,900,000 lekë.
- 1.3. Deklarimi sipas formatit “Vetting” përputhet me deklarinimin e subjektit të vlerësimit në ILDKPKI të vitit 2017.

Pas analizës dhe vlerësimit të provave të paraqitura, mundësia për kursim në momentin e blerjes së kësaj prone, është paraqitur në tabelën si më poshtë:

Tabelë nr. 1

	Përshkrimi	Vlera
1.	Apartament sipërfaqe 58.6 m ² me adresë ***, Tiranë, data e blerjes 17.06.1999	1,700,000 lekë
2.	Të ardhurat nga shitja e apartamentit me adresë ***, në Tiranë, datë 14.06.1999	1,900,000 lekë
3.	Shporta e konsumit ⁴	180,000 lekë
4.	Mundësia për kursim (të ardhura-pasuri-shpota e konsumit)	20,000 lekë

Nga vlerësimi i provave të paraqitura, Komisioni konstatoi se prindërit e subjektit të vlerësimit kanë patur burim financiar të justifikueshëm për blerjen e kësaj prone.

2. Shtesë apartamenti⁵ me sipërfaqe 27.7 m² me adresë “****” në Tiranë në emër të nënës znj. H. H., të vëllait z. L. H., dhe të subjektit të vlerësimit.

Burimi i krijimit: çelja e trashëgimisë përfituar nga babai

- Kontratë për privatizimin e banesave datë 17.05.1993, Rruga ***, Fier. Çmimi i banesës është 23,625 lekë dhe trualli 2,520 lekë.

² Me shkresë me nr. *** Prot., datë 11.10.2019

³ Me shkresë me nr. *** Prot., datë 17.10.2019

⁴ Për llogaritjen e shportës të konsumit trupa e vlerësimit është bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pranë KJV me shkresë me nr. *** Prot., datë 04.09.2019. Shpenzimet e konsumit për vitin 1999 janë përlogaritur 5,000 lekë në muaj për frymë.

⁵ Dokumentacion justifikues i dorëzuar nga subjekti:

- Çertifikatë për vërtetim pronësie, nr. ***, Z.V.R.P.P Tiranë, zona kadastrate nr. ***, nr. i pasurisë ***, z.k. ***, sipërfaqe totale 27.7m². Çertifikata është në emër të subjektit të vlerësimit, nënës dhe vëllait. Pjesa takuese është 1/3.

- Leje legalizimi, nr. ***, datë 25. 05. 2016, z.k. ***, nr. i pasurisë ***

Pjesa takuese: 1/3
Vlera e deklaruar: Shtesa është e pavlerësuar

Fakte që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

2.1.Subjektit të vlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me shumën e investuar në tërësi dhe të pjesës takuese në këtë investim.

2.2.Në shpjegimet e dorëzuara pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit⁶, deklarohet nga subjekti se:

- Shtesa është ndërtuar në vitin 1999. Investim i përbashkët nga të gjithë banorët e pallatit pesë katësh në tokë shtetërore.
- Subjekti i vlerësimit nuk ka informacion, nëse është kërkuar leje në bashki para ndërtimit të shtesës nga banorët e pallatit.
- Burimi i deklaruar për këtë investim është vlera prej 5,000\$ e dërguar nga vëllai i subjektit të vlerësimit që jeton në SHBA që prej vitit 1997⁷.
- Dokumentacioni për legalizim është paraqitur pranë ALUIZNIT në vitin 2006⁸ nga babai i subjektit të vlerësimit z. Sh. H.
- Leja e legalizimit është në emër të babait të subjektit të vlerësimit.
- Regjistrimi i shtesës në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme, është bërë pas çeljes së trashëgimisë ligjore datë 02.07.2016.

2.3. Komisioni administroi Dëshmi Trashëgimie Ligjore, nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 02.07.2016. Sipas këtij dokumenti rezulton se subjekti i vlerësimit gëzon 1/3 pjesë takuese.

2.4.Nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug⁹, konfirmohet se babai i subjektit të vlerësimit ka vetëdeklaruar për legalizim me nr. *** prot., datë 27.09.2006, për ndërtimin në Rr. ***, njësia administrative ***, Tiranë. Leja e legalizimit nr.*** datë 23.05.2016, është në emër të babait të subjektit të vlerësimit për shtesën e apartamentit. Sipas dokumentacionit të kësaj dosje, vlera e investimit për shtesën e apartamentit bërë nga babai i subjektit z. Sh. H. është 759,977 lekë (27.7m² x 27,436 lekë).

2.5.Deklaratë datë 07.06.2019, në prani të noterit publik të shtetit të Floridas, SHBA nga vëllai i subjektit të vlerësimit z. L. H., me vendbanim Florida, SHBA ku shprehimisht thuhet se “ është dërguar shuma prej 5,000\$ prindërve për ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 1999”¹⁰.

2.6.Subjekti i vlerësimit, ka vënë në dispozicion të Komisionit, dokumentacionin justifikues për të ardhurat e përfituara nga punësimi i vëllai z. L. H. në SHBA gjatë viteve 1997 dhe 1999.

Në deklaratën e tij, në prani të noterit publik datë 3.10.2019 të shtetit të Floridas, SHBA vëllai i subjektit shpjegon punësimin e tij nga viti 1997 deri në vitin 1999, si dhe ka bashkëlidhur dokumentat për të ardhurat bruto dhe neto të realizura në vitin 1997 dhe 1999 nga punëdhënësit.

Sa më sipër, në total të ardhurat neto rezultojnë në vlerën 8,795.06\$ të llogaritura sipas vërtetimeve të lëshuara nga kompanitë si më poshtë vijon:

- Të ardhurat bruto nga punësimi në kompaninë “***”, për vitin 1997 janë 4,015.16\$, ndërsa të ardhurat neto janë 3,346.19\$.

⁶ Me shkresë me nr. *** Prot., datë 24.09.2019

⁷ Deklaratë noteriale të dërguar nga vëllai z. L. H.

⁸ Deklarata personale e babait të subjektit të vlerësimit është bërë në datë 03.04.2006 pranë njësisë vendore nr. ***.

⁹ Me shkresë me nr. *** Prot., datë 17.10.2019

¹⁰ Bazuar në kursin zyrtar mesatar të këmbimit për vitin 1999 (1\$= 138.25lekë), vlera e dërguar është 691,250 Lekë

- Të ardhurat bruto nga punësimi në kompaninë “***”, për vitin 1999 janë 3,746\$, ndërsa të ardhurat neto janë 3,152.02\$.
- Të ardhurat bruto nga punësimi në kompaninë “***”, për vitin 1999 janë 2,502.50\$, ndërsa të ardhurat neto janë 2,296.85\$. Në total të ardhurat neto për vitin 1999 janë 5,448.87\$.

Komisioni kreu analizën financiare si më poshtë vijon:

Tabelë nr.2

	Përshrimi	Vlera
1.	Pasuri, shtesë apartament me sipërfaqe 27.7 m ² në Tiranë	759,977 lekë
2.	Të ardhurat prej 5,000\$	691,250 lekë
3	Mundësia për kursime (të ardhura-pasuri)	-68,727 lekë

ALUIZNI i është referuar koston së ndërtimit në momentin e legalizimit të objektit, që është viti 2016 dhe jo koston reale të ndërtimit të objektit në vitin 1999.

Deklarimi sipas formatit “Vetting” përputhet me deklarin e subjektit të vlerësimit në ILDKPKI në vitin 2017.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Hua¹¹ dhënë një personi fizik në vitin 2004 me kontratë noteriale huadhënie. Kontrata e huadhënies nr. * Rep., nr. *** Kol., datë 27.05.2009. Notere z. I .SH.**

Shuma e dhënë hua: 3,000,000 lekë

Pjesa takuese: 100%

Burimi i krijimit: Shitja e shtëpisë 2+1 në qytetin e Beratit dhe kursimet familjare në vite

Fakte që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

Deklarimi sipas formatit “Vetting” përputhet me deklarin e subjektit të vlerësimit në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës pranë ILDKPKI –së, datë dorëzimi 23.05.2017.

Dega vendore e noterëve Tiranë¹², notere I. Sh., ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratën e huadhënies me nr. *** Rep., dhe nr. *** Kol., datë 27.05.2009 mes bashkëshortit të subjektit të

¹¹ Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar dokumentacionin justifikues:

- Kartelë të pasurisë të paluajtshme, z.k. ***, nr i pasurisë *** , Berat
- Kërkesë për regjistrim dhe lëshim Certificate
- Kontratë blerje të pasurisë, 4 Shtator 1993, nga Ndërmarrja Komunale Banesa, Berat të apartamentit në adresën ***. Blerësit znj. Q. V. dhe z. P. V. Çmimi i privatizimit 8,630 lekë duke përfshirë edhe vlerën e truallit. Dhoma e Noterisë e rrethit Berat, nr. *** Rep., nr. *** Kol., notere z. E. H.
- Akti i marrjes në dorëzim të banesës shtetërore, datë 05.02.1972 nga z. M. V.

¹² Me shkresë me nr. *** Prot., datë 06.08.2019

vlerësimit dhe shtetases A. Q. Në këtë kontratë është përshkruar fakti që kjo shumë i është dhënë huamarrëses në Janar të vitit 2004 nëpërmjet një marrëveshje verbale mes palëve. Afati i lidhjes së kontratës, ka filluar në datë 01.01.2004 dhe ka përfunduar në datë 30.06.2009.

Shkresa sqaruese e subjektit të vlerësimit në lidhje me këtë kontratë noteriale dorëzuar pranë Komisionit me nr. *** Prot., datë 15.02.2020, përshkruhet si më poshtë vijon:

“...bashkëshorti në Janar 2004 i ka dhënë hua për një afat tre mujor shumën 3,000,000 lekë, në mirëbesim pa patur ndonjë marrëveshje zyrtare noteriale. Shuma 3,000,000 lekë ishte shuma e lekëve që disponimin nga shitja e shtëpisë në Berat dhe nga kursimet familjare. Kjo shumë ishte mbledhur nga ana jonë për blerjen e një apartamenti në Tiranë, pasi nuk disponimin shtëpi. Afati i kthimit tre mujor nuk u respektua nga huamarrësja. Dhe pas këtij afati bashkëshorti në mënyrë të vazhdueshme ka kontaktuar dhe kërkuar huamarrëses që t’i kthej shumën, por ajo nxirrte justifikime të ndryshme dhe nuk kthente shumën e marrë hua. Në këto kushte bashkëshorti dyshoi se mund të ndodhej para një mashtrimi nga ana e saj dhe vendosi t’i kërkojë huamarrëses të nënshkruanin një kontratë huadhënie në një zyrë noteriale, për të patur një dokument për veprimin e kryer. Kontrata u nënshkrua në datë 27.05.2009. Gjatë gjithë periudhës që nga 01.01.2004 - 15.02.2020 nga huamarrësja nuk është kthyer shuma e marrë hua...”

...pavarësisht nga sa më sipër subjekti ka deklaruar se në zbatim të dispozitave të Kodit Civil me mbarimin e afatit të kontratës, data 30.06.2009, kontrata ka pushuar fuqinë e saj juridike dhe nuk sjell efekte për vitet e mëpasme....”

Komisioni administroi deklaratën noteriale¹³ me nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 18.04.2018 të nënshkruar pranë noterës z. Xh. O., nga huamarrësja z. A. Q., në të cilën deklarohet se nuk është shlyer shuma e marrë hua. Kjo deklaratë është hartuar në përmbajtje të kontratës së huasë të lidhur datë 27.05.2009.

Komisioni kreu analizën financiare të burimeve të financimit për periudhën e kohës deri në fund të vitit 2003, si më poshtë:

Tabelë nr. 3

Përshkrimi	Të ardhura (1)	Shpenzime sipas INSTAT (2)	Mundësia për të kursyer (3)
Nga shitja e shtëpisë në Berat, datë 20.10.1999	1,900,000 lekë		
Nga pagat neto nga puna e bashkëshortit të subjektit të vlerësimit deri më 31.12.2003	917,795 lekë		

¹³ Me shkresë me nr. *** Prot., datë 17.02.2020

Nga pagat neto nga puna e subjektit të vlerësimit deri më 31.12.2003	1,403,236 lekë		
Totali	4,221,031 lekë	807,456 lekë	3,413,575 lekë (3=1-2)

Komisioni konstatoi se, subjekti i vlerësimit dhe bashkëshorti me të ardhurat e deklaruara dhe të vërtetuara nga dokumentacioni provues, justifikon mundësinë financiare për dhënien e kësaj huaje.

Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

Trupa e Vlerësimit e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit bazuar në parimin e ligjshmërisë, barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, si dhe duke garantuar të drejtën e subjektit të vlerësimit për një proces të rregullt ligjor arriti në përfundimin se, subjekti i vlerësimit ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin. Nga hetimi rezultoi se subjekti i vlerësimit ka patur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë dhe shpenzimet e kryera.

Në vlerësimin e përgjithshëm subjekti i vlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Për vlerësimin e kontrollit të figurës të subjektit të vlerësimit, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë verifikimin e deklarimeve të subjektit në shtojcën 2 të vetëdeklarimit, për të vërtetuar saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, si dhe identifikimin e rasteve që janë përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.
2. Subjekti i vlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi Formularin e Deklarimit për Kontrollin e Figurës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.
3. Është e pajisur me certifikatë sigurie të nivelit tepër sekret, me datë lëshimi 26.04.2017.
4. Subjekti i vlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtin emër, mbiemër si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës.
5. Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale, apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.
6. Nuk ka asnjë informacion apo indice që të implikojë subjektin e vlerësimit në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cënim të figurës.
7. Nuk ka denoncime nga publiku në faqen zyrtare të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, www.kjv.al.
8. Nuk ka patur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht nga Avokati i Popullit.

9. Subjekti i vlerësimit nuk rezulton të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, nuk rezulton të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish –Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991, sipas dokumentacionit të dërguar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish –Sigurimit të Shtetit.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka vënë në dispozicion formularët e vetë deklarimit të subjektit të vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar. Format i “Vetting” i dorëzuar nga subjekti i vlerësimit është i njëjtë me të dhënat e formularit të vetë deklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, të ndryshuar.
11. Në përputhje me pikën 2, neni 38 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe deklarimeve personale, subjekti i vlerësimit ka kryer testin psikologjik të personalitetit. Në bazë të rezultateve të përfituara gjatë realizimit të vlerësimit psikologjik, konkludon se: (i) subjekti i vlerësimit nuk paraqet probleme të shëndetit mendor, si rrjedhim është mendërisht e aftë të funksionojë në aspektin okupacional, ndërpersonal dhe social. (ii) Paraqet marrëdhënie të stabilizuara personale dhe ndërpersonale. (iii) Subjekti i vlerësimit nuk paraqet problematika të personalitetit që mund të çenojnë plotësimin e detyrimeve dhe aktivitetin e saj në tërësi, si dhe shfaq shkallë të lartë të funksionimit në plotësimin e këtij aktiviteti.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

Trupa e Vlerësimit e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i vlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, informacione nga organe ligjzbatuese, dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, arriti në përfundimin se subjekti i vlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

Nuk u provua që subjekti i vlerësimit ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë e përfshirë nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen të përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim, trupa e vlerësimit vlerësoi se subjekti i vlerësimit znj. Aida Veizaj, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit është kryer në bazë të nenit 43 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ku “Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimit të rregullave të etikës, si dhe i përmbushjes së detyrave nga punonjësi, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

2. Komisioni konstatoi se, arsimi i subjektit të vlerësimit është në përputhje me kriteret e pozicionit të punës të mbajtur ndër vite nga subjekti i vlerësimit.
3. Subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore për të gjithë periudhën e punësimit të saj.
4. Bazuar në nenit 46, pika 3 e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, punonjësi ka të drejtë të zgjedhë e të paraqesë për vlerësim tri dokumente zyrtare të përgatitura.

- **Plan veprimi për përmirësimin e sistemit të sigurisë së kufirit në standardet e shteteve anëtare të BE-së (Rilindja Kufitare).**

Ky është një studim dhe draft plani masash i përgatitur nga subjekti i vlerësimit, si përfaqësuese e grupit të punës “Për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të studimit për modernizimin e infrastrukturës e të shërbimit në pikat e kalimit kufitar dhe терминаlet doganore të Republikës së Shqipërisë”, grup i ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr 153, datë 05.10.2018.

Fushat kryesore në të cilat ky plan shtrihet janë:

- Përmirësimi i legjislacionit për kufirin dhe migracionin dhe përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së.
- Përmirësimi i infrastrukturës institucionale dhe administrative të Policisë Kufitare dhe Migracionit.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar.
- Forcimi i bashkëpunimit me agjensitë e tjera ligjzbatuese.
- Forcimi i kapaciteteve teknike dhe logjistike për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit.
- Përmirësimi i imazhit të Policisë Kufitare dhe Shërbimit ndaj Publikut.
- Modernizimi i infrastrukturës së kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit.

Subjekti i vlerësimit në materialin e sipërpërmendur identifikon problemin, bën një analizë të detajuar të problemeve të konstatuara në punën e Departamentit për Kufirin dhe Emigracionin, bazuar kjo dhe në përvojën e fituar në këtë department. Përqëndrohet në atë që është thelbësore, për të evidentuar rezultatet e pritshme të arritjes së kësaj strukture. Propozon për zgjidhje të reja më efektive dhe efçente. Në këtë material vihet re një qasje sistemike për të trajtuar dhe zgjidhur problemet.

- **Tre marrëveshje bashkëpunimi:**

- **Marrëveshje Bashkëpunimi**, lidhur midis ILDKPKI –së dhe Drejtorisë së Policisë të Shtetit në datë 30.07.2015.
- **Marrëveshje bashkëpunimi** “Për shkëmbim informacioni dhe dhënien e të drejtës së konsultimit në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe në sistemin TIMS të Policisë së Shtetit” në datë 10.08.2016.
- **Marrëveshje bashkëpunimi** “Për përcaktimin e kushteve të bashkëpunimit midis DPSH dhe ZQRPP për shkëmbimin e informacionit, për identifikimin, hetimin e pasurive të paligjshme të veprës penale dhe pastrimit të parave” në datë 21.07.2015.

Marrëveshjet janë hartuar me strukturë të standardizuar dhe teksti është i qartë dhe i plotë.

- **Procedura standarde për hetimin e pastrimit të parave**

Në këtë material të paraqitur nga subjekti i vlerësimit, vihet re unifikimi i rregullave dhe dhënia e udhëzimeve standarde për hetimin e pastrimit të parave. Analiza është e plotë.

5. Vlerësimi i aftësive individuale të punës bëhet nga eprori direk bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në

grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës. Për të gjithë periudhën e deklaruar, subjekti i vlerësimit ka vlerësim maksimal. Në mënyrë të veçantë janë vlerësuar integriteti, organizimi i ngarkesës së punës, bashkëpunimi me të tjerët dhe standardet e larta në përmbushjen me cilësi të detyrës.

6. Sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ kryesisht konstatohet se fitimi i gradave është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në momentin e marrjes së gradës.
7. Komisioni konstatoi se, funksionet që ka mbajtur subjekti i vlerësimit në vite janë në përputhje me gradat respektive.

Konkluzioni për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar

Trupa e Vlerësimit e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit arrin në përfundimin se, nga vlerësimi i aftësive profesionale subjekti i vlerësimit znj. Aida Veizaj është e aftë për vendin e saj të punës, duke treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të përshkrimeve të punës, të përcaktuara për funksionin e mbajtur, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është e frytshme dhe efektive në masë të pranueshme.

V. KONKLuzioni Përfundimtar

Trupa Vlerësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit znj. Aida Veizaj, në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të besueshëm të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupa e Vlerësimit e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, znj. Aida Veizaj, me funksion Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

2. Vendimi i njoftohet me shkrim subjektiv të vlerësimit brenda 15 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
3. Ky vendim ankimohet pranë Gjykatës Administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatën administrative dhe gjykim të mosmarrëveshjeve administrative.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datë 21.02.2020.

TRUPA E VLERËSIMIT

Elvira Daberdaku

Kryesues

Elida Liko

Relator

Ana Kapaj

Anëtar